




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-32436/22 datë: 17.11.2022



Npi – 01/392 datë: 25.11.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 25.11.2022 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VIII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 25.10.2022 (e premtë) në ora 09:00 h. në sallën e Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar, z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, znj.Valmira Hoxha, praktikante, dhe z.Shqiprim Hyseni.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.10.2022,
2. Draft-Rregullore për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në komunën e Shtimes, (pas diskutimit publik)
3. Draft-Strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025, (pas diskutimit publik)
4. Propozim-Vendim për transfer dhe rialokim të ndarjeve buxhetore të shpenzimeve Komunale për vitin 2022,
5. Draft-Plani i Punës i Grupit Jo-Formal të Grave për vitin 2023.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, ne pajtohemi me këtë rend dite, të vazhdojmë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.10.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi, Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e KPF-së, e mbajtur më 27.10.2022.**

Pika 2

Draft-Rregullore për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në komunën e Shtimes, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Kjo rregullore i ka shteruar gjitha mundësit, janë bërë dy tri ndryshime edhe është në harmoni të plotë me Udhëzimin Administrativ të 2019.

z.Përparim Ramusa; Pasi që edhe ti e potencove Kryesues se është gjithçka në rregull ti rekomandojmë Kuvendit që ta miratoj këtë rregullore.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, me qenë se ka kaluar gjitha debatet publike, ish kanë mirë Drejtori i Administratës me na e elaboruar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E potencova më herët e di që janë bërë dy tri ndryshime, dhe e di që është në harmoni të plot me Statutin e Komunës dhe U.A 05/2019 .

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi ti rekomandoj Kuvendit miratimin Rregullores për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në Komunën e Shtimes.**

Pika 3

Draft-Strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Edhe kjo Draft-Strategji ka pas një komision shumë profesional, dhe gjatë diskutimit publik, besoj që në dokumente është në rregull.

z.Përparim Ramusa; Në aspektin juridik i plotëson kushtet, ti rekomandojmë Kuvendit që të miratojë këtë Draft-Strategji.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e Strategjis për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025.**

Pika 4

Propozim-Vendim për transfer dhe rialokim të ndarjeve buxhetore të shpenzimeve Komunale për vitin 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Përshëndetje, e kemi një propozim për transfer, përmbajtja është si në vazhdim (shih dokumentin). Kërkojë nga ju ta miratoni këtë kërkesë ose këto mjete do të shkojnë në suficit.

z.Përparim Ramusa; Dua me ja bërë një pyetje zyrtarit kryesor financiar, këto janë shpenzime komunale, njëra ishte prej shkollës në shkollë e tjera prej shkollës në inspektorat. A mundesh pak më shumë me na dhënë sqarime?

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Po në vazhdim lexoi dokumentin. (shih dokumentin)

z.Kadri Emini; Më interesoj ky rialokimi prej Arsimit në Inspeksion. Cili drejtor ka kërkuar a ka mirkuptim.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Në takimet e rregullta që i kemi realizuar, na rezulton që kemi mbetje. Kërkesën e inspeksionit dhe aprovimin e drejtorit, i kemi me vete, pra dakordim kemi, të aprovuara janë nga drejtorët. Nuk ka me pas mungesë në mjete, por kjo është teprica e cila do të bartet. Në takime janë kërkesat e tyre, që mos me fut pika shumë herë por vetëm një herë.

znj.Adelina Beqaj; Faleminderit, zyrtarit kryesor financiar, kam një pyetje, kjo kërkesa prej shkollës në inspektorat, a ka ndonjë kërkesë specifike të tyre.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Pika për të cilën unë po flas mundet drejtori me ta dhënë përgjigjen, unë jam për me fol vetëm për rialokim. Kërkesa e tyre është për ndriqim publik, takim ka pas, ato çka janë jashtë kompetencave të mija, mundeni vetëm drejtorit me ju drejtuar.

z.Përparim Ramusa; Mendoj se Kuvendi duhet ta mbështesë këtë Propozim-Vendim. E elaborojë shumë mirë zyrtarit kryesor financiar. Te Çerdhja ju paskan tepruar do mjete, kurse në anën tjetër kemi inspeksionin që ka do obligime të rrymës ende pa i kryer.

z.Kadri Emini; Pajtona me parafolësin, por kishte qenë e rrugës që me pas këtu për elaborim drejtorin që i merren mjetet dhe drejtorin që i kan tepruar. I rekomandoj edhe unë Kuvendit që ta mbështes këtë Propozim-Vendim.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje. Po ndërlidhem me pjesën e diskutimit të fundit. Këto dakordime dhe konsulta janë çështje të brendshme të ekzekutivit, ndërsa neve na vjen vetëm finalja e këtij Propozim – Vendimi. Është mirë ti rekomandojmë Kuvendit që të kalojë ky Propozim – Vendim, është rrugë ligjore dhe iniciativë e mirë.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Po ndihna i obliguar me thanë që si procedim është që mos mu pru çdo herë në Kuvend, kemi dashur me planifikuar me kohë. Nëse nuk kishim pasur pëlqim nuk do të kishim mundur me proceduar me këtë rialokim, pra na nuk do ta kishim sjell në Kuvend po të mos kishim pasur dakordim.

z.Përparim Ramusa; Unë krejt drejtorët i shohë ashtu si Kryetarin, z.Qemajl Aliu, nuk besoj që është mbetje e madhe, nuk kemi arsye mos me e votuar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; besoj e kemi të qartë të gjithë, kuorumin e kemi po e hedhi në votim.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e vendimit për transfer dhe rialokim të ndarjeve buxhetore të shpenzimeve Komunale për vitin 2022.**

Pika 5

Draft-Plani i Punës i Grupit Jo-Formal të Grave për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha znj.Adelina Beqaj, për prezantimin e kësaj pike.

znj.Adelina Beqaj; Pas takimit që kemi pasur me zyrtarët e OSBE-së dhe me zyrtarin për te drejtat e njeriut kemi formuar Grupin Jo-formal të Grave. Më pastaj kemi hartuar edhe draft-planin e punës të grupit Jo-formal të punës për vitin 2023. (shih dokumentin) Unë po kërkoj aprovimin e juaj, në mënyrë që të fillojmë punët si Grup-Jo-Formal i Grave në vitin 2023.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ju përgëzoj për këtë plan. Dua të di prej sa anëtarëve përbëhet grupi edhe a ka anëtarë edhe jashtë grupit të Kuvendit Komunal.

znj.Adelina Beqaj; Grupi ka filluar me të gjitha grat, qëllimi jonë është ta kemi edhe një grua nga bizneset në Komunën e Shtimes, janë cekur institucionet të cilat munden me qenë pjesë e këtij grupi. Nëse e shihni se duhet të shkoj në diskutim publik, por pasi është jo formal ju vendosni.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kisha kërkuar që ta kemi edhe një grua nga Komunitetet, kemi një rekomandim nga Komiteti për Komunitete që më ka ardhur, konkretisht ata propozojnë që të jetë znj.Shkurta Behluli. Ju sugjeroj që të jetë kjo anëtare nga Komunitetet.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit, për një plan të tillë, besoj që nëse arrin me bë këtë grup funksional, këto gra i kisha quajtur lidere të avancimit të drejtave dhe lirive të grave në Komunën tonë. Nuk kemi arsye që mos mi rekomanduar Kuvendit që ta miratoi këtë plan.


znj.Adelina Beqaj; Kam parasysh kërkesën tuaj Kryesues, ka vend për gjitha grat. Për herë të parë bëhet një plan i grupit Jo-Formal, qëllimi i këtij grupi është që të luftojmë për barazi, dhe të jemi sa më dinjitoze.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Është mirë që në të ardhmen t'ju përkrahim si Kuvend edhe nga ana financiare, kur u diskutua për buxhet besoj që do të ketë një buxhet të ndarë për këtë grup. Neve si Kuvend na mbetet me bashkëpunuar.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e Planit të Punës për vitin 2023 të Grupit Jo-Formal të Grave.**

Pasi diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesi mledhjen e përfundoi në ora 09:47h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

